



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Nr. 455 / Prot.
2

Patos, më 17 . 02 . 2026

MIRATOI
KRYETARI
Fation Duro



PROJEKTVENDIM

Nr. 12 , datë 17 . 02 . 2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2026

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 30 të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, bashkia është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullësor dhe miratim nga Këshilli Bashkiak të planit për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor brenda muajit mars të çdo viti.

Përsa më sipër i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e Planit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026 sipas shtojcës 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur relacioni shpjegues.

Grupi i punës

Çajup Refitaj

Blerina Laçi

Valbona Semanjaku

Donald Xhafa

Juriste

Joana Sherifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Nr. 455/13 Prot.

Patos, më 14 . 02 . 2026

RELACION
“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR MBROJTJEN E PYJEVE
DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2026”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe në nenin 30 të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, paraqesim sot për miratim “Planin e Masave për Mbrojtjen e Pyjeve nga Zjarri”, plan i hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.

Ky plan ka për qëllim të sigurojë gatishmërinë dhe reagimin efikas ndaj zjarreve për të mbrojtur pyjet dhe sigurinë e komunitetit.

Plani përmban shkaqet kryesore të rënies së zjarrit në pyje, faktorët që ndikojnë në rritjen e rriskut për shfaqjen e zjarreve si dhe masat për parandalimin e zjarreve në pyje.

Nga hartimi dhe zbatimi i këtij plani synohet zvogëlimi i riskut në Ekonomitë Pyjore të bashkisë Patos.

Përsa më sipër për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe zbutjen e riskut të zjarreve në pyje i kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin e Planit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026.

Për zbatimin e këtij plani ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile dhe Sektori i MZSH-së.

GRUPI I PUNËS

Çajup Refitaj

Blerina Laçi

Juriste

Joana Sherifi

Valbona Seranajaku

Donald Xhafa

ZV KRYETARE

Ina Sauli




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Nr. 455 / Prot.

Patos, më 17.02 .2026



MIRATOI
KRYETARI
Faton Duro

PLANI I MASAVE PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE
KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2026

Përmbajtja

I.	Hyrje	3
II.	Shkaqet e rënies së zjarrit	3
III.	Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota	4
IV.	Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve në pyje	4
V.	Masat për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota	5
	5.1 Masa preventive	5
	5.2 Masa përgatitore	5
	5.3 Masa direkte	6
VI.	Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota	6
VII.	Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor	7

I. HYRJE

Bazuar në ligjin nr. 115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, bashkisë Patos i janë shtuar dhe dy ish-komunat Zharrëz dhe Ruzhdie. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit sektorial bashkia është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullësor.

Sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, i ndryshuar, në tabelën e mëposhtme jepen sipërfaqe pyjore për secilën njësi administrative.

Nr.	Njësia Administrative	Sip. totale (ha)	Pyje/kullota (ha)	Lloji drusor
1	Ruzhdie	651.33	633	Pishë, Lis dhe Shkurre
2	Zharrëz	31.42	12	Plep, Akacie dhe Ekualipt

Duke patur parasysh sipërfaqen, shpërndarjen dhe rëndësin e madhe të fondit pyjor duhet të kushtohet një rëndësi e madhe administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri.

Ky plan ka për qëllim të sigurojë gadishmërinë dhe reagimin efikas ndaj zjarreve për të mbrojtur pyjet dhe për të ruajtur sigurinë e komunitetit.

II. SHKAQET E RËNIES SË ZJARRIT

Arsyet e rënies së zjarrit janë nga më të ndryshmet por në bazë të përvojave të mëparshme në 99 % të rasteve si shkak paraqitet njeriu (direkt apo indirekt). Rrufeja apo vetëndezja zënë vetëm 1 % të rasteve. Rënia e zjarrit në pyje/kullota në rastet kur shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje ose i qëllimshëm. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë apo kryejnë punime në pyje/kullota apo në afërsi të tyre. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e hershme ku vegjetacioni barishtor i vitit të kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Në këtë rast shkaktarë të zjarrit mund të jenë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjuetarët, fermerët apo dhe turistët. Zjarret e qëllimshëm bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat pa llogaritur pasojat e këtyre zjarreve. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për të përfituar dru të lirë (për dru zjarri apo ndërtim), për të mbuluar prerjet ilegale, etj.

III. KLASIFIKIMI I ZJARREVE NË PYJE/KULLOTA

Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti klasifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nënsipërfaqësor
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës
- Zjarr në kurorat e drurëve
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar

Më të përhapur në bashkinë tonë janë tre raste e fundit.

Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht bimësi si bar, filiza, shkurre, etj. Në varësi të kushteve dhe pranisë së erës, flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2 m. Shpejtësia e përhapjes së këtij zjarri (pa erë të fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

Zjarri në kurorat e drurëve është një zjarr që ndodh vetëm në kulm apo kurorë të drurëve. Ky lloj zjarri mund të jetë fillesa e një zjarri të kombinuar për shkak të kushteve specifike të djegies dhe shpejtësia e përhapjes mund të arrijë deri në 20 km/h.

Zjarri i përgjithshëm ose i kombinuar përfshin djegien sipërfaqësore si dhe atë të kurorave. Shkalla e përhapjes së këtyre zjarreve në varësi të terrenit, llojit të drurëve si dhe shpejtësisë së erës mund të arrijë deri në 20 km/h.

Përhapja e zjarrit zakonisht zhvillohet në tre faza: faza fillestare, kërcimi i zjarrit dhe faza e qetësimit. Zjarrëfikësit dhe jo vetëm, duhet të njohim fazat e përhapjes së zjarrit në mënyrë që të shmangin rrezikun në momentin që ndodh kërcimi i zjarrit për të shmangur kërcënimin e rrezikut për jetën e tyre.

IV. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË RRRITJEN E RREZIKUT PËR SHFAQJEN DHE ZHVILLIMIN E ZJARREVE NË PYJE

Faktorët më të rëndësishëm janë:

- Lloji i bimësisë
Lloji i bimësisë është një nga faktorët kryesor që ndikojnë në shkallën e rrezikut nga zjarri. Kështu pyjet halorë ndizen më lehtë se ato gjetherënës. Drurët dritëdashës janë më të rrezikuar kjo për shkak se përbërja e pyllit me këta lloje drurësh është më e rrallë.
- Topografia
Topografia apo relievi i terrenit së bashku me llojin e tokës luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ndezshmërisë. Në përgjithësi në terrenet, të cilët kanë reliev të fortë me orientim nga jugu është lehtësisht më i ndezshëm se sa ai i orientuar nga veriu.
- Stina

Stinët me karakteristikat e tyre ndikojnë në ndezshmërinë e pyjeve. Vera me temperatura të larta të ajrit dhe periudha të gjata pa reshje, e rrisin shkallën e ndezshmërisë në pyje/kullota. Në këtë periudhë bari thahet, lagështia e tokës zvogëlohet në mënyrë drastike dhe përbën rrezik për zjarr duke e cilësuar si “periudha kritike e vitit për shfaqjen e zjarreve në hapsirë të hapur”.

- Karakteristikat klimaterike

Klima në rajonin tonë është tipike mesdhetare dhe është favorizuese për zjarret si në hapsira të hapura edhe në zonat e pyjeve.

- Komunikacioni

Sikur e përmendëm më sipër shkaku kryesor i zjarreve (me apo pa qëllim) është njeriu. Hapja e rrugëve në zonat pyjore apo në afërsi të tyre për qëllime rekreative, turizëm apo për mbledhjen e produkteve të ndërmjetme pyjore, përbën rrezik për zjarr. Pavarësisht efekteve negative, nga ana tjetër ka efekt pozitiv pasi mundëson një kontroll më të mirë të zonës apo qasje më të shpejtë të zjarrfikësve dhe automjeteve në rast zjarri.

V. MASAT PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarrit, sipas kohës kur ndërmerren dhe qëllimit, ndahen në:

5.1 Masa preventive

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë vitit. Nisur nga fakti se njeriu është në 99 % të rasteve shkaktar i zjarreve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i tyre. Në këtë kuadër masat preventive janë:

- Ligjore: Mbrojtja e pyjeve rregullohet me ligje dhe akte nënligjore dhe është përgjegjësi e të gjithëve, pronarëve si dhe subjekteve që i menaxhojnë ato.
- Edukative: Janë masa që përfshijnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithëve grupmoshave. Mënyrat e edukimit janë të ndryshme ku mund të përmendim orë mësimore në shkollë, leksione të hapura, përdorimi i revistave, fletëpalosjeve, etj.
- Informative: Qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si dhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet dhe me atë edukative.

5.2 Masa përgatitore

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve është e nevojshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përhershme gjatë gjithë vitit dhe përfshijnë:

- Krijimi i strukturës vrojtimit-sinjalizim;
- Transferimi i informacionit mbi zjarrin;
- Përcaktimi i kalimeve të mundshme në rast zjarri në ekonomitë pyjore, si më poshtë:
 - Fatos-Ruzhdie-Gjinoqarë

- Patos-Siqecë-Drenie
 - Patos-Visokë-Lapulec-Lofkënd-Drenie
 - Patos-Kasnicë
 - Patos-Zharrëz-Belinë
- Organizimi/riorganizimi i skuadrave vullnetare dhe trajnimi i tyre nga struktura e MZSH Patos;
 - Ndërtimi i kanaleve kundra zjarrit;
 - Përgatitja e planveprimit për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

3.3 Masa direkte

Pavarësisht se mund të ndërmerren masat më të mira preventive dhe përgatitore, zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye duhet të merren masa direkte. Këto janë masa që ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij.

Për të lokalizuar dhe shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementët nga i quajtori trekëndëshi i Osborn-it, të cilët janë materiali djegës, burimi i nxehtësisë dhe oksigjeni. Në bazë të elementit që do të neutralizohet dhe metodës që do të përdoret, metoda e shuarjes së zjarrit ndahet në:

- Shuarje e zjarrit me tokë: Metoda e vjetër e përdorur për këtë qëllim konsiston në përdorimin e materialit të tokës (dheut) si izolator, pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si izolant i nxehtësisë, përkatësisht i energjisë termike për djegien e drurit.
- Shuarja e zjarrit me ujë: Është metoda tradicionale në shuarjen e zjarreve ku veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë.
- Luftimi i zjarrit me zjarr: Ndonëse duket konfuze, kjo metodë është efektive por kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë pasi mbart në vetvete rrezik. Në varësi të taktikës së shuarjes së zjarrit, në një distancë të caktuar ndizet një zjarr i kontrolluar që mund të lëvizë në anë të kundërt ose në të njëjtë me drejtimin e zjarrit, i cili djegë materialin para frontit të zjarrit dhe kur zjarri arrin në atë sipërfaqe nuk ka çfarë të djegë më dhe shuhet.
- Shuarja e zjarrit nga ajri me kimikate: Në këtë metodë përdoren kimikate të ndryshme dhe alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi shpërbëhen nëpërmjet ujit.
- Shuarja e zjarrit me eksplozivë: Kjo metodë është kryesisht ndihmëse për të rrëzuar pemë, gërrim kanalesh, krijim pengesash, etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet “re pluhuri”, e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër duke ndikuar kështu në uljen e intensitetit të zjarrit deri në shuarjen e tij.

VI. VEPRIMET KRYESORE GJATË ZBULIMIT TË ZJARRIT NË PYJE/ KULLOTA

Është detyrë qytetare e çdo individi, në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e dhënies së

informacionit, saktësia dhe përmbajtja varet suksesi i aksionit të shuarjes së zjarrit. Hapat që duhet të ndërmerren janë:

- Telefonimi në numrin 128 (pa pagesë) të Shërbimit Zjarrfikës ose në numrat e personave të kontaktit të vendosur nga bashkia.
- Identifikimi i informuesit, dhënia e gjeneraliteteve (emër, mbiemër).
- Përcaktimi i vendndodhjes së saktë të zjarrit (duke dhënë pika orientuese të sakta si emri i vendit, toponimi apo objekte të njohura).
- Përcaktimi i llojit të bimësisë që po digjet (dru, shkurre, barishtore, etj.).
- Nëse vërehet diçka e dyshimtë afër vatrës së zjarrit psh automjet, duhet të mundohet të shënohet targa ose të mbahet mend.
- Nëse mendohet se zjarri mund të shuhet me mjete rrethanore duhet të ndërhyet në rast të kundërt duhet të largohet në një distancë të sigurtë.

VII. PLANI I MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR

Plani i masave të propozuara bazohet në përgjegjësitë dhe kompetencat e dhëna në legjisllacionin si më poshtë:

- Ligj nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 152, datë 21.12.2012 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”.
- VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

Bashkia Patos nëpërmjet strukturave të saj (Njësive Administrative, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Sektorit të MZSH, Sektorit të Emergjencave Civile, etj) për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:

Nr.	Masa Organizative	Afati	Strukturat përgjegjëse
1	Ngritja e shtabeve të mbrojtjes nga zjarri në pyje në Njësitë Administrative Ruzhdië dhe Zharrië	Shkurt 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
2	Organizimi i sistemit të vërtetimit-sinjalizimit me anë të strukturës së pyjeve (roje dhe mirëmbajtës)	Mars 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
3	Organizimi/riorganizimi i strukturave vullnetare të mbrojtjes nga zjarri.	Prill 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
4	Trajnimi i strukturave vullnetare për shuarjen e zjarrit në pyje/kullota.	Maj 2026	Sektori i MZSH Sektori i Emergjencave Civile
5	Përgatitja e hartës së zonave pyjore/kullosore të rrezikuara nga zjarri.	Maj 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile
6	Informim dhe sensibilizim i komunitetit, nxënësve të shkollave mbi rëndësinë e pyjeve dhe kullotave si dhe masat për mbrojtjen nga zjarri.	Gjatë gjithë vitit 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Sektori i Emergjencave Civile Sektori i MZSH
7	Realizimi i takimeve me administratorët e njësive, komunitetin, subjekte që veprojnë në pyje, barinj për parandalimin e rënies së zjarreve në pyje/kullota.	Maj-Tetor 2026	Drejtoria e Zhvillimit ekonomik
8	Struktura e shërbimit pyjor gjatë periudhës së emergjencës (gadishmërisë) maj-tetor duhet të kenë të njohura çdo lëvizje dhe për të duhet të njoftojnë eprorin.	Maj-Tetor 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomike
9	Vrojtuesit gjatë periudhës së gadishmërisë duhet të njoftojnë eprorin 2 herë në ditë, ora 0800 dhe 1800 mbi situatën në zonën e tyre të vërtetimit. Çdo njoftim do të pasqyrohet edhe në Librin e Gadishmërisë që do të ketë secili punonjës.	Maj-Tetor 2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

10	Shtabi për mbrojtjen nga zjarri në pyje në rastet e zjarreve masive, sipas situatës që krijohet, kërkon ndihmë për përballimin e situatës te Institucioni i Prefektit Fier.	Gjatë gjithë vitit 2026	Sektor i Emergjencave Civile Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Sektor i MZSH
----	---	-------------------------	--

PUNOI

Blerina Laçi

Valbona Semanjakul

Donald Xhafa

KONFERMOI

Çajup Refritaj